



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2019:135129

Datë: 15.08.2024

Numri i dokumentit: 06053973

C.nr.127/2018

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, në çështjen juridike kontestimore të paditësit E (F) Sh nga fshati Xërxë, Komuna e Rahovecit, ndaj të paditurve E.K, A.K dhe A.Sh, që të gjithë nga fshati Xërxë, Komuna e Rahovecit, me objekt kontesti kompensimi i mjeteve, me vlerë të kontestit të kontestit 5,000.00 euro, jashtë seance më datën 15.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET E TËRHEQUR padia e paditësit E (F) Sh nga fshati Xërxë, Komuna e Rahovecit, ndaj të paditurve E.K, A.K dhe A.Sh, që të gjithë nga fshati Xërxë, Komuna e Rahovecit, në çështjen juridike kontestimore, C.nr.127/2018.

Secila palë i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësi E (F) Sh, më datën 20.04.2019, në këtë gjykatë ka parashtruar padinë me objekt kontesti kompensimi i mjeteve.

Gjykata ka tentuar të ju dërgojë aktvendimin për përgjigje në padi së bashku me padinë dhe shkresat tjera të paditurve, mirëpo nga fletëkthesat e të njëjtëve është konstatuar se palët janë të panjohura dhe njëkohësisht kërkesa është e paqartë. Prandaj, gjykata me aktvendimin e saj C.nr.127/2018 të datës 14.06.2024, e ka kthyer në plotësim padinë, ashtu që paditësi në afat prej 3 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, ta përmirësojë dhe plotësojë padinë, të i sigurojë adresat e sakta të të paditurve E.K, A.K dhe A.Sh si dhe ta përcaktojë saktë kërkesën e tij.

Për shkak se paditësi është i panjohur në fshatin Xërxë, Komuna e Rahovecit, ndërsa i njëjti nuk ka dhënë asnjë adresë të tij në Gjarmani, me aktvendimin C.nr.127/2018 të datës 03.07.2024, ka vendosur që komunikimi me paditësin të bëhet përmes tabelës së shpalljeve të kësaj gjykate, bazuar në nenin 116.5 të LPK-së.

Kështu, gjykata ka vendosur ta konsiderojë të tërhequr padinë e paditësit E (F) Shnga fshati Xërxë, Komuna e Rahovecit për faktin se padia e paditësit për gjykatën ka qenë e paqartë dhe se nga dita kur aktvendimi i kësaj gjykate është publikuar në tabelën e shpalljeve të kësaj gjykate, ka kaluar afati për plotësimin dhe përmirësimin e saj.

Kështu, në nenin 99.2 të LPK-së parashihet se *“Parashtruesat duhet të jenë të kuptueshme dhe të përmbajnë çdo gjë që nevojitet dhe e mundëson veprimin sipas tyre. Ato duhet të përmbajnë sidomos: emrin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin (emërtimin e personit juridik), vendbanimin apo vendqëndrimin (selinë e personit juridik) e palëve, të përfaqësuesve të tyre ligjor apo me prokurë, po që se i kanë, objektin e kontestit, përmbajtjen e deklaratës dhe firmën e parashtruesit.”* Ndërsa në nenin 102.3 të LPK-së parashihet se *“Do të konsiderohet se është tërhequr parashtruesi po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtruesi do të hidhet poshtë.”*

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, që secila palë t’i bartë këto shpenzime, është marrë në kuptim të nenit 450 të LPK-së pasi që secila palë paraprakisht vet i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta.

Prandaj, nga ajo që u tha më lartë, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e në bazë të nenit 99 dhe 102 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil  
C.nr.127/2018, më datën 15.08.2024

Gjyqtari  
Berkan Hamza

**KËSHILLË JURDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.